



REPUBLIC OF KOSOVO  
OPŠTINA SHTËRPECË  
LLAZAR DOLISE  
01/Br.Prot. 01-020/08-19000/19  
Nr.Prot. 1  
Br.str. 1  
Nr. i fq. 1  
Datum 31.12.2019  
Data 31.12.2019  
SHTËRPECË - SHTËRPECË



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština štrpce

Komuna e Shtërpcës

Municipality of Strpce

Në mbështetje të nenit 12, dhe 40 para (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të dispozitave të nenit 34 të Statutit të Komunës së Shtërpcës 01-Nr 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpcës në mbledhjen e mbajtur më 26.12.2019 miraton këtë:

#### V E N D I M

#### PËR MIRATIMIN E PLANIT TE PUNES SE KUVENDIT TE KOMUNES SE SHTERPCES PER VITIN 2020

1. Miratohet plani i punës se Kuvendit te Komunës se Shtërpcës për vitin 2020 sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit te Kuvendit Komunal

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic



REPUBLIKA E KOSOVES  
OPETIA E SHËRËS KOMUNE SHTËRPECË

NUM. PUN. 101 AZNI - DAI.ESB  
K. PUN. 01-020/08-19000/19  
S. SH. 1  
M. E. 1  
Data 31.12.2019  
SHTËRPECË - SHTËRPECË

# Plani I punës së kuvendit të Komunës së Shtërpcës për vitin

2020

## **VËREJTJET HYRËSE:**

Kuvendi komunal është organi më i lartë i komunës i cili kryen funksionet themelore të qeverisë lokale, të përcaktuara me Kushtetutë, ligj dhe me statutin e komunës. Kuvendi komunal përfaqëson dhe mbron interesat e qytetarëve aq sa është e organizuar mirë, e përgatitur dhe e suksesshme në marrjen e vendimeve të drejta të cilat janë me rëndësi për qytetarët e komunës dhe organet e qeverisë lokale. Plani i punës së kuvendit komunal për vitin vijues përmban renditjen e shqyrtimeve dhe aprovimeve të vendimeve të rëndësishme, rregulloreve komunale, raporteve, strategjive, aprovimin e buxhetit dhe temat tjera të cilat sipas ligjit do të gjenden në rendin e ditës së kuvendit komunal në vitin 2020.

Andaj, qëllimi i këtij dokumenti është lehtësimi dhe avancimi i punës së kuvendit komunal me qëllim që ajo të jetë sa më funksionale, më mirë e organizuar, më transparente dhe e suksesshme në punën e saj.

## **KUVENDI KOMUNAL:**

Kuvendi komunal është organ më i lartë ligjdhënës dhe përfaqësues i komunës i cili drejtpërdrejtë në zgjedhje zgjedhet nga qytetarët. Kuvendi komunal përbëhet nga këshilltarët, kryesuesi i kuvendit dhe zëvendës kryesuesi për komunitete. Kuvendi komunal Shtërpçë numëron nëntëmbëdhjetë (19) këshilltarë. Këshilltarët nga radhët e veta me votë të fshehtë zgjedhin kryesuesin e kuvendit, mandati i të cilit është i njëjtë sikurse mandati i këshilltarëve të kuvendit komuna ( 4 vite). Zëvendës kryesuesi për komunitete i takon kandidatit të partisë politike, i cili në zgjedhjet ka fituar më shumë vota në komunitetin pakicë në komunë.

E drejta është si dhe obligimi i këshilltarëve që të marrin pjesë në punën e kuvendit komunal dhe komiteteve të tij, propozon kuvendit diskutimin lidhur me çështjet e caktuara, parashtron propozim vendime dhe akte tjera nga kompetencat e kuvendit komunal dhe jep amandmane në propozimet e rregullave , parashtron pyetje lidhur me punën e organeve komunale dhe merr pjesë në aktivitetet tjera të kuvendit komunal.

Seancat e kuvendit komunal janë të hapura për qytetarë, media, organizata joqeveritare, grupet e interesit dhe publikun e gjerë përveç në rastet e seancave të mbyllura të cilat janë të parapara me ligj. Kuvendi komunal do të mbajë së paku dhjetë seanca në vit, ku prej tyre pesë duhet të mbahen në gjashtë muajt e parë të vitit, siç është e paraparë me Rregulloren e punës.

## **KOMPETENCAT E KUVENDIT KOMUNAL:**

Kuvendi komunal mund të aprovon akte në kuadër të kompetencave të veta. Aktet e kuvendit komunal vlejnë në territorin e komunës e cila i ka aprovuar këto akte. Disa nga aktet më të rëndësishëm të cilat i aprovon kuvendi komunal janë:

1. Statuti i komunës,
2. Rregullorja e punës së kuvendit komunal,
3. Rregulloret komunale,
4. Aktet tjera juridike të cilat janë të domosdoshme për punë efikase dhe funksionale të komunës.

Kuvendi komunal punën e vet e bazon në ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, statutin dhe aktet tjera nënligjore. Kuvendi komunal nuk mund të bart autorizime të cilat janë vetëm nën kompetencat e kuvendit komunal, e ato janë:

1. Aprovimin, ndryshimin dhe revokimin e statutin të komunës, rregullores së punës së kuvendit komunal dhe rregulloreve komunale,
2. Lejimin e buxhetit dhe planeve investuese,
3. Lejimin e çështjeve tjera financiare të cilat janë të rezervuara për kuvendit komunal sipas statutit apo rregullores së punës.
4. Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor,
5. Themelimin e komisioneve të përhershme të kuvendit,
6. Zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit të kuvendit komunal,
7. Lejimin e nivelit të taksave dhe ndëshkimeve,
8. Vendosjen dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujt e nderit,
9. Emërtimin dhe ndryshimin e rrugëve dhe vendeve tjera publike në komunë,
10. Lejimin e marrëveshjeve ndërkomunale dhe komunale,
11. Marrja e vendimeve për kyçjen e shoqatave përfaqësuese të komunave, dhe
12. Të gjitha përgjegjësit tjera të parapara me rregullat pozitive-juridike të Kosovës.

#### KALENDARI I AKTIVITETEVE:

|        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|--------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| JANAR  | <p><b>Seanca e parë e Kuvendit Komunal----</b> _____ <b>JANAR 2020.</b></p> <p><b>Rendi i ditës:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës</li> <li>2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar</li> <li>3. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendim për mbajtjen e një debatit publik për plan zhvillimor të komunës</li> <li>4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për zyrën e prokurimit për vitin 2020</li> <li>5. Raporti i kryesuesit të kuvendit mbi realizimin e planit të punës për vitin 2020</li> <li>6. Të ndryshme</li> </ol> <p><b>Aktivitetet përcjellëse:</b></p>                                                                                                                                       |
| SHKURT | <p><b>Seanca e dytë e Kuvendit Komunal SHKURT -----</b> _____ <b>2020.</b></p> <p><b>Rendi i ditës:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës</li> <li>2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar</li> <li>3. Raporti i Komitetit Komunal për Siguri ne Bashkesi.</li> <li>4. Raporti vjetor i punës së kryetarit</li> <li>5. Prezantimi i raportit përfundimtar financiar i kryetarit për vitin 2019</li> <li>6. Shqyrtimi dhe aprovimii i Rregullores për bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe zonat urbane</li> <li>7. Raporti vjetor i Komitetit për Politik dhe Financa</li> <li>8. Raporti vjetor i Komitetit për komunitete</li> <li>9. Të ndryshme</li> </ol> <p><b>Aktivitetet përcjellëse:</b></p> |
| MARS   | <p><b>Seanca e tretë e Kuvendit Komunal MARS-----</b> _____ <b>2020.</b></p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|---------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|         | <b>Rendi i ditës:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës</li> <li>2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar</li> <li>3. Plani i Veprimit për Transparencën për vitin 2020</li> <li>4. Të ndryshme</li> </ol> <b>Aktivitetet përcjellëse:</b>                                                                                                                                                                                                                                      |
| PRILL   | <b>Seanca e katërt e Kuvendit Komunal PRILL ----- 2020.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
|         | <b>Rendi i ditës:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës</li> <li>2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar</li> <li>3. Prezantimi dhe shqyrtimi i raportit tremujor financiar për periudhën janar – mars 2020 dhe raporti mbi nivelin e pagesës të hyrave vetanake</li> <li>4. Formimi i grupit punues për hartimin e planit akcional për pjesëmarrje të publikut në aprovimin e buxhetit për vitin 2021-2023</li> <li>5. Të ndryshme</li> </ol> <b>Aktivitetet përcjellëse:</b> |
| MAJ     | <b>Seanca e pestë e Kuvendit Komunal MAJ----- 2020.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|         | <b>Rendi i ditës:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës</li> <li>2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar</li> <li>3. Aprovimi i planit akcional për pjesëmarrje të publikut në aprovimin e buxhetit për vitin 2021-2023</li> <li>4. Të ndryshme</li> </ol> <b>Aktivitetet përcjellëse:</b>                                                                                                                                                                                     |
| QERSHOR | <b>Seanca e gjashtë e Kuvendit Komunal QERSHOR ----- 2020.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|         | <b>Rendi i ditës:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës</li> <li>2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar</li> <li>3. Shqyrtimi dhe aprovimi i kornizës afatmesme buxhetore për vitin 2021-2023</li> <li>4. Të ndryshme</li> </ol> <b>Aktivitetet përcjellëse:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Debati publik mbi draft kornizën afatmesme buxhetore për periudhën 2021-2023.</li> </ol>                                                                           |
| KORRIK  | <b>Seanca e shtatë e Kuvendit Komunal KORRIK ----- 2020.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|         | <b>Rendi i ditës:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës</li> <li>2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar</li> <li>3. Raporti gjashtëmujor i punës së kryetarit</li> <li>4. Prezantimi dhe shqyrtimi i raportit gjashtëmujor financiar për periudhën janar – qershor 2020 dhe raporti mbi nivelin e pagesës të hyrave vetanake</li> <li>5. Raporti gjashtëmujor i Komitetit për Siguri në Bashkesi.</li> <li>6. Të ndryshme</li> </ol> <b>Aktivitetet përcjellëse:</b>          |

|                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|----------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Debati publik për propozim buxhetin e komunës për vitin 2021-2023</li> <li>2. Debati publik për rregulloren e komunës mbi tatimin në pronë për vitin 2021</li> </ol>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>GUSHT</b>   | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>PUSHIMI VEROR</b></li> </ol>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>SHTATOR</b> | <p><b>Seanca e tetë e Kuvendit Komunal SHTATOR ----- 2020.</b></p> <p><b>Rendi i ditës:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës</li> <li>2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar</li> <li>3. Aprovimi i draft buxhetit për vitin 2021</li> <li>4. Aprovimi propozim rregullores komunale për tatimin në pronë për vitin 2020</li> <li>5. Shqyrtimi dhe aprovimi i hartës së zonimit në komunën e Shtërpçës</li> <li>6. Të ndryshme</li> </ol> <p><b>Aktivitetet përcjellëse:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>7. Debati i trete publik për propozim buxhetin komunal</li> <li>8. Debati publik për investimet kapitale për vitin 2021-2023</li> </ol> |
| <b>TETOR</b>   | <p><b>Seanca e nëntë e Kuvendit Komunal TETOR ----- 2020.</b></p> <p><b>Rendi i ditës:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës</li> <li>2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar</li> <li>3. Prezantimi i raportit nëntëmuor financiar për periudhën janar – shtator 2019 dhe raporti mbi pagesën e të hyrave vetanake</li> <li>4. Të ndryshme</li> </ol> <p><b>Aktivitetet përcjellëse:</b></p>                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>NËNTOR</b>  | <p><b>Seanca e dhjetë e Kuvendit Komunal NËNTOR----- 2020.</b></p> <p><b>Rendi i ditës:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës</li> <li>2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar</li> <li>3. Formimi i komisionit për hartimin e planit të punës së kuvendit</li> <li>4. Të ndryshme</li> </ol> <p><b>Aktivitetet përcjellëse:</b></p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>DHJETOR</b> | <p><b>Seanca e njëmbëdhjetë e Kuvendit Komunal DHJETOR ----- 2020.</b></p> <p><b>Rendi i ditës:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës</li> <li>2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar</li> <li>3. Aprovimi i planit të punës së kuvendit për vitin 2020</li> <li>4. Të ndryshme</li> </ol>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |

